



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL**

**Nr. 11243-03674-00-2013 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2022-378 i Vendimit (475)**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

**Sokol SADUSHI - Kryesues
Ilir PANDA - Anëtar
Ervin PUPE - Anëtar /Relator**

Me pjesëmarrjen e sekretares Brunilda Ago, më datë 11.11.2022 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile me nr. 11243-03674-00-2013 akti që iu përket palëve:

PADITËS: Trashëgimtarët ligjorë (të të ndjerit) Sadik Shkoza

PADITUR: Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë
Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit

OBJEKTI: Anullim i vendimit nr. 380, datë 11.9.2012, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë.
Njohjen e së drejtës së pronësisë së subjektit të shpronësuar Abdyl Shkoza për sipërfaqen prej 97400 m², ndodhur në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
Nenet 32, 153 e vijues, 324 e vijues të Kodit të Procedurës Civile;
Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Ervin Pupe; mbrojtësin e palës paditëse, Av. Maksim Gjokutaj, i cili kërkoi mospranimin e rekursit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2182, datë 24.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë; përfaqësuesin e palës së paditur, Av. Shteti Abaz Deda, i cili kërkoi prishjen e vendimit nr. 2182, datë 24.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë me tjetër trup gjykues; pasi e analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 24.9.2012, me palë, objekt dhe shkak ligjor, sikundër tregohet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. Me anë të Vendimit nr. 380 datë 11.09.2012 Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës dhe mosnjohjen e të drejtës së pronësisë të subjektit të shpronësuar Abdyl Shkoza për sipërfaqen 97.400 metër katrorë, ndodhur në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë.”*

3. Pala paditëse duke mos qenë dakord me këtë akt administrativ, ka kërkuar anulimin e Vendimit nr. 380, datë 11.9.2012, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë dhe njohjen e të drejtës së pronësisë të subjektit të shpronësuar Abdyl Shkoza për sipërfaqen 97.400 metër katrorë, ndodhur në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë.

4. Paditësi ka pretenduar se Vendimi nr. 380, datë 11.9.2012, i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9235/, datë 29.7.2004, *“Për kthimin dhe kompensimin e pronave”*, i ndryshuar dhe i është drejtuar gjykatës me padinë objekt shqyrtimi.

5. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, me vendimin nr. 3514, datë 05.04.2013, ka vendosur:

“-Pranimin e kërkesë padisë.

- Anullimin e Vendimit nr. 380, datë 11.9.2012 e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë.

- Njohjen e të drejtës së pronësisë të subjektit të shpronësuar Abdyl Shkoza për sipërfaqen 97400 metër katrorë, ndodhur në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt rrethi Tiranë, konkretisht parcelat:

Parcela me sipërfaqe 12700 metër katrorë, me indeks harte K – 34 – 100 – (14 – B, 14 – D), me këto kufizime Verilindje – pasuria nr. 430, Juglindje – pasuria nr. 18/45, Jugperëndim – pasuria nr. 18/45, Veriperëndim – pasuria nr. 1845. (Sipas Aktit të Ekspertimit teknik - topografik administruar në dosjen gjyqësore).

Parcela me sipërfaqe 84700 metër katrorë me indeks harte K – 34 – 100 – (15 – C), me këto kufizime Veri – pasuria nr. 18/44 dhe 18/45, Lindje – pasuria nr. 18/45, Jug – pasuria nr. 18/45, Perëndim – pasuria nr. 18/45. (Sipas Aktit të Ekspertimit teknik - topografik administruar në dosjen gjyqësore).

- T'i kthehet në natyrë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar Abdyl Shkoza, sipas dëshmive të trashëgimisë, sipërfaqja 94.400 metër katrorë, ndodhur në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë.

- Parcela me sipërfaqe 12700 metër katrorë, me indeks harte K – 34 – 100 - (14 –B, (14- D me këto kufizime Verilindje – pasuria nr. 430, Jug Lindje – pasuria nr. 18/45, Jug Perëndim – pasuria 18/45, Veriperëndim – pasuria 1845. Sipas Aktit të Ekspertimit teknik - topografik administruar në dosjen gjyqësore).

- Parcela me sipërfaqe 84700 metër katrorë me indeks harte K - 34 – 100- (15 –C), me këto kufizime Veri – pasuria nr. 18/44 dhe 18/45, Lindje – pasuria 18/45, Jug – pasuria 18/45, Perëndim – pasuria nr. 18/45. Sipas Aktit të Ekspertimit teknik - topografik administruar në dosjen gjyqësore).

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.”

6. Kjo gjykatë arsyeton se, sipas dokumentacionit të paraqitur nga pala paditëse provohet se pala e paditëse është trashëgimtare ligjore e subjektit të shpronësuar Abdyl Shkoza. Ky fakt vërtetohet nga Vendimi nr. 7437, datë 9.9.2008 i Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë, Vendimi nr. 1197, datë 19.2.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi nr. 1259, datë 22.2.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Sipas palës paditëse prona objekt gjykimi është mbështetur në dokumentacion hartografik të plotë. Sipas dokumentacionit topografik të ndodhur në dosjen gjyqësore vërtetohet se kjo pronë ndodhet në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë. Paditësi ka pretenduar se Vendimi nr. 380, datë 11.9.2012 i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” (Ligji nr. 9235/2004). Duke marrë në konsideratë kundërshtimet e palës së paditur, pala paditëse ka kërkuar caktimin e një eksperti topograf për të sqaruar të gjitha këto pretendime. Në gjykime të tilla me objekt gjykimi pasuri të paluajtshme, të cilat janë objekt shqyrtimi administrativ dhe gjyqësor prej disa vitesh, nuk mund të mjaftohemi me interpretim të thjeshtë për shkresat zyrtare.

8. Nga Vendimi nr. 8790, datë 29.10.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vërtetim fakti juridik, rezulton se ish pronari Abdyl Shkoza ka pasur në pronësi një sipërfaqe toke prej 97.4 dynym, ndodhur në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt rrethi Tiranë. Ky është një vendim gjyqësor që për aq kohë sa nuk është kundërshtuar në rrugë gjyqësore me palë kundërshtare, ai ka fuqi të plotë juridike. Pala paditëse nuk mundet që të paragjykojë këtë vendim gjyqësor vetëm se është për vërtetim fakti. Vendimet gjyqësore për vërtetim fakti juridik kanë dhënë një ndihmë të konsiderueshme në procesin e njohjes dhe kthimit të pronave për saktësimin e sipërfaqes dhe caktimin e kufijve të pronës. Ky vendim gjyqësor mbetet në fuqi dhe nuk mundet që të anashkalohej fuqia e tij juridike. Pala e paditur nuk ka paraqitur prova për të provuar këtë padi gjyqësore. Pala e paditur ka shprehur rezerva ndaj vendodhjes së pronës objekt gjykimi. Mirëpo vetëm kundërshtimi i këtij fakti nuk mund të përbëjë një bazë të shëndoshë ligjore për rrëzimin e të drejtës së pronësisë.

9. Gjykata, për të marrë një informacion më të plotë të specializuar në lidhje me vendodhjen e pronës së pretenduar objekt gjykimi, ka vendosur të caktojë një ekspert topograf mbi këtë çështje. Nga Akt ekspertiza Teknike Topografike punuar nga eksperti Topo Gjeodet Abdi Llozhi rezulton se prona e subjektit Abdyl Shkoza ndodhet në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë, konkretisht parcela me sipërfaqe 12700 metër katrorë, me indeks harte K – 34 – 100 – 14 –B, 14 – D me këto kufizime Verilindje – pasuria nr. 430, Juglindje – pasuria nr. 18/45, Jugperëndim – pasuria nr. 18/45, Veriperëndim – pasuria 1845 dhe parcela me sipërfaqe 84700 metër katrorë, me indeks harte K – 34 – 100 – (15 –C), me këto kufizime Veri – Pasuria nr. 18/44 dhe 18/45, Lindje – pasuria nr. 18/45, Jug – pasuria nr. 18/45, Perëndim – pasuria nr. 18/45. Ato paraqiten të pa zëna me ndërtime dhe nuk përdoren nga askush në momentin e verifikimit. Nga verifikimi në terren i pronës rezulton se ajo nuk krijon mbivendosje me ndonjë pronë tjetër. Po kështu nga dokumentacioni i ndodhur në dosjen gjyqësore kjo pronë figuron me pronësi shtet.

10. Nga Shkresa nr. 1679, datë 29.7.2011 e Këshillit të Qarkut Tiranë rezulton se nga verifikimi i dokumentacionit kadastral para reformës agrare të vitit 1946, ish pronari Abdyl Shkoza figuron në regjistrin kadastral nr. 3, faqe nr. 16, rrjeshti 30, në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë dhe ka të regjistruara këto prona tokë e punuar 50 dynymë dhe ullinj 341 rrënjë. Nga Shkresa nr. 8303, datë 3.12.2008 e Arkivit Qendror Shtetëror rezulton se ish pronari Abdyl Shkoza figuron në regjistrin kadastral nr. 3, faqe nr. 16, rrjeshti 30, në Fshatin

Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë dhe ka të regjistruara këto prona tokë e punuar 50 dynym dhe 341 rrënjë ullinj.

11. Sa më sipër, pretendimet e palës së paditur mbi mungesën e dokumentacionit tekniko-ligjor, gjykata çmon se këto pretendime janë në kundërshtim me frymën dhe gërmën e dispozitave ligjore për kthimin e pronave ish pronarëve. Ky proces përmbush një të drejtë themelore të njeriut siç është e drejta pronës. Mirëpo kjo e drejtë nuk mund të rrëzohet duke paraqitur pretendime të tilla të pambështetura në ligj. Pala paditëse ka paraqitur shkresa dhe dokumenta zyrtare duke vërtetuar origjinën e pronës dhe të drejtën e pronësisë që shtetasi Abdyl Shkoza ka patur mbi këtë pronë. Kjo palë ka kryer të gjitha kërkimet e saj në lidhje me këtë fakt dhe ka vërtetuar se pretendimi i palës së paditur në lidhje me emrin nuk është i mbështetur në fakte dhe ligj. Pala e paditur nuk ka kryer një hetim të plotë administrativ në lidhje me këtë pretendim. Nuk është e drejtë të rrëzohet e drejta e pronësisë vetëm si pasojë e faktit se pala e paditur nuk është e bindur në gabimet materiale të dokumentacionit të vjetër kadastral. Megjithatë ky fakt juridik është sqaruar më pas me vendim gjykate. Për aq kohë kohë sa institucionet shtetërore kanë të drejtë të bëjnë kërkime të plota dhe të sakta mbi të gjithë dokumentacionin kadastral, nuk mund të cënohet e drejta e pronësisë së shtetasve. Pala paditëse ka paraqitur disa akte shkresore për të provuar saktësinë e emrit të subjekti ish pronar Abdyl Shkoza.

12. Pala e paditur ka pretenduar se pala paditëse nuk mund të mbështetet në fakte të tilla, të cilat minimalisht nuk krijojnë asnjë ide mbi këtë çështje. Pala e paditur ka pretenduar se zëri kadastral ku është pozicionuar prona objekt gjykimi që okuponte 341 rrënjë ulliri nuk përputhet me pronën e sotme. Pala e paditur çdo pretendim e ka trajtuar mbi bazë hamendësimesh. Ndonëse pala paditëse ka paraqitur dokumentacion kadastral në lidhje me tokën e punuar dhe ulla, pala e paditur nuk i ka marrë në konsideratë këto dokumenta arkivore. Pala e paditur nuk mund të pretendojë se kjo pronë do ngelte e njëjtë përsa i përket numrit të rrënjëve të ulla që nga vitet 1930 e deri më sot.

13. Pala e paditur në vendimmarrjen e saj ka marrë në konsideratë informacionin e plotë marrë nga institucionet përkatëse. Ky informacion është shkresor dhe ndodhet në dosjen e palës së paditur. Nuk përbën shkak rrëzimi i të drejtës së pronësisë fakti që pala e paditur nuk bindet në vendimmarrjen e saj, ndonëse ka akte dhe shkresa mbi emrin e subjektit të shpronësuar Abdyl Shkoza. Pala e paditur nuk ka paraqitur asnjë provë shtesë, por vetëm ka interpretuar në një mënyrë tjetër provat mbi të cilat është mbështetur pala paditëse. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij procesi dhe të drejtën e pronësisë si një nga të drejtat themelore, pala e paditur në asnjë moment të procesit gjyqësor nuk ka arritur të bindë gjykatën në lidhje me shkaqet ligjore të Vendimit nr. 380, datë 11.9.2012, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë për rrëzimin e të drejtës së pronësisë.

14. Procesi i kundërshtimit në gjykatë të vendimeve të AKKP-së, për të cilat janë investuar në mënyrë institucionale si AKKP-ja, ashtu edhe institucione të tjera, është një proces i rëndësishëm, si nga pikëpamja administrative, por ashtu edhe nga pikëpamja e pronësisë. Mirëpo gjykata konstaton se për pretendime të tilla nuk është e nevojshme që të krijohen vonesa të tilla në njohjen e të drejtës së pronësisë. Pala e paditur në asnjë moment nuk ka kontestuar në themel dokumentacionin ligjor mbi pronësinë e subjektit Abdyl Shkoza. Në të gjithë vendimin objekt gjykimi, ashtu edhe në procesin gjyqësor fakti i pronësisë së këtij subjekti mbi sipërfaqen e pretenduar nuk është vënë në diskutim. Është pranuar plotësisht se subjekti Abdyl Shkoza ka qenë pronar i kësaj pasurie. Mirëpo pala e paditur në kundërshtim me ligjin ka nguruar të përfundojë procesin e njohjes dhe kthimit të pronës për faktin se në regjistrat kadastralë nuk

është shënuar e plotë sipërfaqja dhe pozicionimi i pronës së pretenduar. Duke marrë në konsideratë periudhën kohore kur është mbajtur ky dokumentacion dhe mënyrën sesi janë ruajtur këto dokumenta arkivore, gjykata çmon se pala e paditur ka cënuar të drejtën e pronësisë se paditëses. Nga dokumentat arkivorë ka rezultuar se subjekti shpronësuar Abdyl Shkoza ka patur në pronësi një sipërfaqë Fshatin Priske e Madhe, Komuna Dajt rrethi Tiranë dhe ka të regjistruara këto prona tokë e punuar 50 dynym dhe 341 rrënjë ullinj.

15. Vendimi objekt gjykimi është i paarsyetuar dhe në kundërshtim me provat dhe faktet që janë paraqitur nga pala paditëse. Pala e paditur ndonëse ka argumentuar se kjo pronë ka qenë e regjistruar në regjistrin kadastral dhe në dokumentat arkivor përsëri ka konkluduar se subjekti Abdyl Shkoza nuk mund të klasifikohet si subjekt i Ligjit nr. 9325/2004. AKKP-ja ka rrëzuar kërkesën e paditësit me pretendimi se mungon dokumentacioni i plotë hartografik.

16. Ndërkohë që paditësi ka paraqitur dokumentat arkivorë, me anë të të cilave vërtetohet origjina juridike e pronës dhe harta përkatëse lidhur me vendodhjen e saj. Pala paditëse ka arritur të provojë pretendimet e saj në mënyrë shkresore dhe të plotë mbi pronësinë e subjektit të shpronësuar Abdyl Shkoza, konkretisht parcela me sipërfaqe 12700 metër katrorë, me indeks harte K - 34 - 100- 14 -B, 14 - D, me këto kufizime Verilindje - pasuria nr. 430, Juglindje - pasuria 18/45, Jugperëndim - pasuria 18/45, Veriperëndim - pasuria 1845 dhe parcela me sipërfaqe 84700 metër katrore me indeks harte K - 34 - 100 - (15 -C), me këto kufizime Veri - Pasuria nr.18/44 dhe 18/45, Lindje - pasuria nr. 18/45, Jug - pasuria nr. 18/45, Perëndim - pasuria nr. 18/45.

17. Nga Shkresa e datës 29.3.2013, lëshuar nga ZVRPP-ja, Tiranë rezulton se prona e pretenduar nga pala paditëse, konkretisht pasuria me indeks harte K - 34 - 100 - (15 -C) ndodhur në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë rezulton se bie në pjesë të paazhurnuar dhe nuk disponohet informacion. Ndërsa pasuria me indeks harte K - 34 - 100 - (14 -B), ndodhur në Fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë bie në pasurinë me nr. 18/45 e regjistruar në vol. 9, faqe 150, ZK 3051, lloji i pasurisë pyll me sipërfaqe 1583620 në pronësinë të shtetit.

18. Gjithashtu edhe nga akti i ekspertimit topografik rezulton se kjo pasuri nuk është e zënë me ndërtime dhe nuk përdorej nga askush në momentin e verifikimit. Nga verifikimi në terren i pronës rezulton se ajo nuk krijon mbivendosje me ndonjë pronë tjetër. Po kështu nga dokumentacioni i ndodhur në dosjen gjyqësore kjo pronë figuron me pronësi shtet.

19. Për këtë arsye gjykata krijon bindjen se janë të gjitha kushtet ligjore dhe faktike që të realizohet procesi i kthimit në natyrë i pronës objekt gjykimi tek trashëgimtarët e Abdyl Shkozës. Pala paditëse ka arritur të provojë si nga pikëpamja ligjore dhe hartografike pronësinë e subjektit Abdyl Shkoza. Gjithashtu nuk rezulton se kjo pronë është e lirë për kthim dhe nuk i është nënshtruar Ligjit 7501/1991, "Për tokën". Duke qenë në këto kushte gjykata çmon t'i kthehet në natyrë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar Abdyl Shkoza konkretisht Sadik Shkoza, sipas dëshmive të trashëgimisë, konkretisht parcelën me sipërfaqe 12700 metër katrorë, me indeks harte K - 34 - 100 - (14 -B, 14 - D), me këto kufizime Verilindje - Pasuria nr. 430, Juglindje - pasuria 18/45, Jugperëndim - pasuria nr. 18/45, Veriperëndim - pasuria nr. 1845 dhe parcelën me sipërfaqe 84700 metër katrorë me indeks harte K - 34 - 100 - (15 - C), me këto kufizime Veri - Pasuria nr. 18/44 dhe nr. 18/45, Lindje - pasuria nr. 18/45, Jug - pasuria nr. 18/45, Perëndim - pasuria nr. 18/45 (Sipas Aktit të ekspertimit teknik topografik administruar në dosjen gjyqësore).

20. **Ndaj këtij vendimi** ka paraqitur ankim pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit, duke parashtruar këto shkaqe, për ndryshimin e vendimit:

20.1. *Vendimi është i pabazuar në ligj dhe prova.*

20.2. *Gjykata e Shkallës së parë ka gabuar në vendimmarrjen e saj pasi dokumentacioni ligjor dhe hartografik i paraqitur nga pala paditëse nuk ka qenë i plotë.*

- *Zëri kadastral ku është pozicionuar prona objekt gjykimi që okuponte 341 rrënjë ulliri nuk përputhet me pronën e sotme.*

- *Eksperti i thirrur nga gjykata ka evidentuar së fragmentet e hartave të vjetra të paraqitura nga pala paditëse janë të padobishme për të mundësuar pozicionin e pronës së pretenduar, duke arritur në të njëjtin përfundim sikurse ka arritur AKKP.*

21. **Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 2182, datë 24.10.2013, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit civil nr. 3514, datë 05.04.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.*

22. Nga ana e këtij kolegji çmohet i bazuar Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka vendosur pranimin e padisë së ngritur në proces.

23. Në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet *“Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.”.*

24. Të gjitha pretendimet e ngritura në ankim nga pala e paditur Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Avokatura e Shtetit gjenden të pabazuara nga Gjykata e Apelit.

25. Në nenin 1 të Kodit të Procedurës Civile është përcaktuar: *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në Kod e në ligje të tjera.”.*

26. Mosmarrëveshja e palëve në proces e kthyer në konflikt gjyqësor ka ngarkuar palët me detyrime procedurale. Në nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile është përcaktuar: *“Pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin që, në përputhje me ligjin të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj.”.*

27. Drejt ka arsyetuar Gjykata e Shkallës së Parë, në lidhje me përcaktimin e natyrës së konfliktit gjyqësor, si dhe në interpretimin dhe zbatimin e Ligjit të posaçëm nr. 9235/2004, *“Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.*

28. Siç është provuar në dy shkallët e gjykimit të çështjes objekt konflikti, paditësi ka paraqitur dokumentat arkivorë me anë të të cilave vërtetohet origjina juridike e pronës dhe harta përkatëse lidhur me vendodhjen e saj. Pala paditëse ka arritur të provojë pretendimet e saj në mënyrë shkresore dhe të plotë mbi pronësinë e subjektit të shpronësuar Abdyl Shkoza, konkretisht parcela me sipërfaqe 12700 metër katrorë, me indeks harte K – 34 – 100 – (14 –B, 14- D), me këto kufizime Verilindje – pasuria nr. 430, Juglindje – pasuria nr. 18/45, Jugperëndim – pasuria nr. 18/45, Veriperëndim – pasuria nr. 1845 dhe parcela me sipërfaqe 84700 metër katrorë me indeks harte K – 34 – 100 – (15 –C), me këto kufizime Veri – Pasuria nr. 18/44 dhe 18/45, Lindje – pasuria nr. 18/45, Jug – pasuria nr.18/45, Perëndim – pasuria nr. 18/45.

29. Nisur nga sa është provuar në dy shkallët e gjykimit nga ana e këtij kolegji çmohet se ankimi i ushtruar pranë kësaj gjykate është tërësisht i pabazuar.

30. Paditësi në proces ka ezauruar të gjithë rrugën e mundshme administrative, si dhe përgjatë rrugës procedurale është përpjekur që të vërtetojë më parë dhe në rrugë gjyqësore faktet juridike që sjellin pasojë për të dhe palën e paditur në proces.

31. Ashtu siç ka arsyetuar dhe gjykata e shkallës së parë, paditësi ka provuar se është subjekt i ligjit të sipërcituar. Ai ka të shënuar në regjistrin përkatës pronën e trashëgimlënësit të tij Abdyl Shkoza, por që është i mangët për përlogaritjen e sipërfaqes, pasi ajo ka qenë në strukturën e ullishtes dhe ka patur të përcaktuar numrin e rrënjëve të kësaj kulture. Në seancë gjyqësore me ndihmën dhe të ekspertit është saktësuar sasia e kësaj prone dhe kufitarët e saj.

32. Veç sa ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë duhet të theksohet se indirekt provohet pronësia e paditësit në proces dhe nga kufitarët e kësaj prone, pasi janë të gjithë të fisit të tij që ashtu siç dhe ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë mund t'i përcaktojnë kufijtë e pronave të tyre me vullnetin e tyre të lirë ose së bashku mund t'i saktësojnë dhe me ndihmën e gjykatës, por që nuk janë objekt i kësaj çështje gjyqësore, ndaj ankimi dhe për këtë pjesë gjendet i pabazuar.

33. Nisur nga analiza e sipërcituar çmohet i pabazuar ankimi i të paditurit dhe i zyrës së avokaturës së shtetit, si mjet procedural për mbrojtjen ndaj Vendimit nr. 3514, datë 5.4.2013, të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë, i cili ka zgjidhur konfliktin gjyqësor drejt, ndaj vendimi duhet të lihet i pacënuar.

34. **Kundër vendimit** nr. 2182, datë 24.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, më datë 22.11.2013, ka paraqitur recurs Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, e cila kërkon shqyrtimin e rekursit dhe kalimin e çështjes për gjykim; ndryshimin e vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe rrëzimin e padisë së paditësi, duke parashtruar këto shkaqe:

34.1. *Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Apelit Tiranë kanë bërë një vlerësim të gabuar të dokumentit ligjor nëpërmjet të cilit pala paditëse pretendon origjinën e pronësisë së pronës së pretenduar.*

34.2. *Pretendimi i paditësit për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës me sipërfaqe 97,4 dynymë mbështetet mbi vërtetimin kadastral të lëshuar nga SAMT Këshilli i Qarkut Tiranë nr. 9, datë 12.1.2007, me të cilin vërtetohet pronësia mbi dy kufijtë e të cilës janë përcaktuar me vendimin nr. 8790, datë 29.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Tiranë) në emër të Z. Abdyl Shkoza..*

34.3. *Përsa i përket sipërfaqes së pretenduar prej 47,4 dynymë evidentojmë se kjo parcelë lidhet me regjistrimin kadastral të 341 rrënjë ullinj. Abdyl Shkoza, sipas vërtetimit kadastral ka pasur në pronësi 341 rrënjë ullinj dhe jo një sipërfaqe të caktuar toke ku ndodhej kjo ullishte. Pra, pala paditëse si në vitin 2005, ashtu edhe në vitin 2009 ka kërkuar para gjykatës së Rrethit Tiranë vërtetimin juridik të faktit dhe përcaktimin e kufijve të sipërfaqes së tokës ku ndodheshin 341 rrënjë ullinj të konvertuar sipas paditësit në 47,4 dynymë.*

34.4. *Sa më sipër referuar nenit 4 të Ligjit nr. 7836, datë 22.6.1994, "Për çmimet e tokës bujqësore për efekt kompensimi", një rrënjë ulliri zë një sipërfaqe toke nga 60 m² rezulton se sipërfaqja që zënë 341 rrënjë ulliri është 20,4 dhe jo 47,4 dynymë. Pra edhe nëse marrim konvertimin 60 m² rezulton se sipërfaqja 341 rrënjë ulliri është 20,4 dynymë dhe jo 47,4 dynymë. Gjithashtu, edhe zëri kadastral i kësaj parcele të pretenduar nga korrespondenca me institucionet e treta dhe konkretisht ZVRPP Tiranë e SAMT Këshilli i Qarkut Tiranë konfirmojnë zërin kadastral "Pyll", ndërsa me vërtetimin kadastral rezulton e regjistruar "Ullinj". Referuar rëndësisë që ka kjo kulturë nuk mendojmë që në këtë zonë të ketë pasur një shpyllëzim të kësaj ullishte pa ndonjë shkak madhor, gjithsesi pala paditëse nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion shkresor që të vërtetojë këtë shpyllëzim.*

34.5. *Nga analiza e dokumentacionit hartografik të depozituar në dosje konstatohet se prona është e ndarë në tre parcela:*

- *Parcela Hani i Gjyshit me sipërfaqe 12700 m² me nr. 18/1. Referuar fragmentit të hartave të vitit 1937 dhe 1963 nuk është bërë i mundur identifikimi i pronës, pasi fragmenti i hartës së 1937 është shumë i vogël, ndërsa fragmenti i hartës 1963 nuk ka të përcaktuar shenja*

konvencionale për të përcaktuar llojin e pasurisë së pretenduar. Po kështu Xhaferr Gurra si kufitar jugor, Xhafer Seferi kufitar lindor dhe Jakup Shkoza si kufitar perëndimor nuk kanë vendime njohje të së drejtës së pronësisë në favor të tyre që të identifikohen tre kufijtë e pronës së pretenduar. Pra, nga mospërputhja e llojit të pasurisë pasi ZVRPP ka përcaktuar "Pyll", si dhe nga mosidentifikimi i tre kufitarëve arrihet në konkluzionin së sipërfaqja e pretenduar nuk është pozicionuar saktë.

- Parcela Vvri me sipërfaqe 37300 m² me nr. kadastral 18/1.

- Edhe për këtë sipërfaqe pala paditëse nuk plotëson kriteret e Ligjit nr. 9235/2004, të ndryshuar për njohjen e së drejtës së pronësisë për arsyet që parashtruan më lart.

- Së dyti: Gjykatat nëpërmjet hetimit gjyqësor duhej që të sheshonin mospërputhjet dhe pasaktësi midis përmbajtjes së dokumentit të origjinës së pronësisë, vërtetimit kadastral të lëshuar nga SAMT Këshilli i Qarkut Tiranë nr. 90 prot., datë 12.1.2007 dhe vendodhjes aktuale të kësaj prone. Pozicionimi i pasaktë i pronës së pretenduar evidentohet edhe në aktin e ekspertimit të kryer nga eksperti i thirrur nga gjykata, ku në përgjigje të pyetjes së tretë eksperti ka përshkruar llojin e pasurisë sipas konfirmimit të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor prona me emërtim "Hani i Gjyshit" ndodhet në ekonominë pyjore Zallherr, Priskë në parcelën 136/A me gjendje kadastrale fond pyjor "Pyll", pra nuk korrespondon me zërin kadastral të vërtetimit kadastral me nr. 226 prot., datë 9.9.2008, ku 50 dynmë janë tokë e punuar dhe jo pyll. Në përgjigje të pyetjes nr. 4, ku kërkohet nëse prona e pretenduar krijon mbivendosje me pronat e tjera, pasi sipas shkresës nr. 7934/1 prot., datë 19.8.2011 të ZVRPP Tiranë, rezulton se njëra nga parcelat e pretenduara krijon mbivendosje me pronën e njohur me Vendimin nr. 254, datë 12.5.2006 të KVKKP Tiranë në emër të Hajdar Shkozës, eksperti përgjigjet se pronat në terren (pra me kqyrje të lirë) nuk krijon mbivendosje me pronën e Hajdar Shkozës dhe se paditësi nuk ka pretendime për vendosjen e këtij kufiri. Pra, vendosja e kufirit jugor të kësaj parcele mund të vendoset me mirëkuptim mes dy palëve duke anashkaluar vendimin e gjykatës për përcaktimin e kufijve, të paraqitur nga pala paditëse gjatë shqyrtimit administrativ. Po kështu, edhe kufiri jugor i parcelës "Vvri" S2+S3 në raport me kufitarin jugor Ibrahim Shkoza edhe nga eksperti është evidentuar se nuk mund të pozicionohet, pasi nuk disponon dokumentacion ligjor. Gjithashtu, theksojmë se edhe eksperti i thirrur nga gjykata ka evidentuar se fragmentet e hartave të vjetra të paraqitura nga pala paditëse janë të padobishme për të mundësuar pozicionimin e pronës së pretenduar duke arritur kështu në të njëjtin përfundim sikurse AKKP në vlerësimin e saj.

- Së treti: Pala paditëse duhet të provojë në rrugë administrative ose gjyqësore faktin se është zhveshur në mënyrë të padrejtë dhe të plotë nga pronësia ndërmjet shpronësimit, konfiskimit, shtetëzimit apo marrjes me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga regjimi i kohës. Gjykata nuk kanë analizuar apo hetuar në rrugë gjyqësore mbi mënyrën se si është humbur e drejta e pronësisë. Barra e provës bie mbi palën paditëse. Hetimi gjyqësor në këtë drejtim është i detyrueshëm dhe parashikohet shprehimisht në nenin 2, të Ligjit nr. 9235/2004

Së katërti: Gjykatat në dhënien e vendimeve të tyre duhej të merrnin në konsideratë nenin 17/3 të Ligjit nr. 9235/2004. Në kushtet kur pretendimi për njohjen e pronësisë bazohet mbi një dokument të origjinës së pronës që është vërtetuar në rrugë gjyqësore, sipas nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile dhe jo në një gjykim me palë kundërshtare të saktësimin të kufijve sipas nenit 167 të Kodit Civil etj., pretendimi i paditësit për pronësinë mbetet i paprovuar. Fakti që paditësi ka një fillim prove me shkresë për vërtetimin e faktit të pronësisë dhe të kufitarëve nuk e legjitimon atë që të kërkojë njohjen e së drejtës së pronësisë, pasi ai është thjesht një vendim deklarativ edhe pse i formës së prerë nuk është detyrues për të tretët që nuk kanë qenë thirrur

gjatë gjykimit, siç mund të jetë AKKP Tiranë.

Së fundmi: Akti administrativ që kundërshtohet nëpërmjet padisë, Vendimi nr. 380, datë 11.9.2012 i AKKP-së Tiranë është i drejtë dhe në përputhje me ligjin. Ai nuk përmbush asnjë nga elementët e parashikuar në nenet 115, 116, 117, 118 të Kodit të procedurave Administrative për t'u konsideruar absolutisht apo relativisht i pavlefshëm. Në përputhje të nenin 18, pika 1 të Ligjit nr. 9235/2004, AKKP-ja Tiranë është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për njohjen, kthimin, dhe kompensimin e pronës së subjektit të shpronësuar dhe të vendosë shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të kërkesave të subjekteve të shpronësuar dhe të vendosë shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të kërkesave të subjekteve të shpronësuar për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës.

35. **Gjykata e Lartë**, me vendim të ndërmjetëm të datës 09.04.2015, vendosi: *“Kalimin e çështjes civile nr. 11243-03674-00-2013 për shqyrtim në seancë gjyqësore.”.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

36. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), paraprakisht vlerëson të nevojshme të evidentojë faktin e ndryshimeve ligjore që ka pësuar Kodi i Procedurës Civile (KPC) me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (Ligji nr. 44/2021), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 71, datë 14.5.2021 dhe ka hyrë në fuqi më datë 29.5.2021, i cili në nenin 32 të tij “*Dispozita kalimtare*”, parashikon se: *“Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.”.* Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji zbaton parashikimet e ligjit nr. 44/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

37. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë, parashikohen në nenin 472, të Kodit të Procedurës Civile (para ndryshimeve të sjella me Ligjin nr. 38/2017), Kjo dispozitë, në momentin e paraqitjes së rekursit parashikonte se: *“Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë, në rastet që përcaktohen nga ky Kod, mund të ankimohen me recurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur:*

- a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji;*
- b) ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi);*
- c) shfuqizuar.”.*

38. Kolegji, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi objektin dhe shkakun ligjor të padisë, vendimet e gjykatave të faktit dhe pretendimet e ngritur në recurs, vlerëson se shkaqet e ngritura në recurs janë nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC, në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit dhe e cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit.

39. Konkretisht, lidhur me të drejtën e pronësisë së palës paditëse, sipas arsyetimit të gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe sipas akteve që ndodhen në dosje, si dhe sikundër ka arsyetuar edhe pala e paditur AKKP me vendimin e saj nr. 380, datë 11.9.2012, “Për njohjen e të drejtës së pronësisë, kthimin dhe ose kompensimin e pronës (i administruar në dosjen gjyqësore), në faqen 9 të këtij vendimi ka evidentuar (citim): *“Pretendimi i subjektit kërkues, për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës me sipërfaqe prej 97,4 dynymë të ndodhur në fshatin Priskë e Madhe, Komuna Dajt, Tiranë, mbështetet mbi Vërtetimin kadastral lëshuar nga SAMT Këshilli i Qarkut Tiranë nr. 9 prot., datë 12.1.2007, me të cilin vërtetohet pronësia e sipërfaqes prej 50*

dynymë (kufijtë e së cilës janë përcaktuar me Vendimin nr. 8790, datë 29.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë), në emër të Z. Abdyl Shkoza, duke e konsideruar kështu Z. Abdyl Shkoza, si subjekt të shpronësuar në bazë të nenit 2 të Ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar.”.

40. Pra, sikundër rezulton nga ky vendim, pala e paditur pranon se paditësi disponon dokumentacion për të vërtetuar pronësinë e sipërfaqes prej 50 dynymë. Problematika që AKKP ngre lidhur me këtë sipërfaqe ka të bëjë me përcaktimin e identifikimin e kufijve dhe vendodhjen e pronës.

41. Nga sa më sipër, lidhur me sipërfaqen prej 50 dynymë, Kolegji vlerëson se ka prova të mjaftueshme që i ndjeri Abdyl Shkoza, trashëgimlënës i palës paditëse, ka qenë pronar i kësaj sipërfaqeje toke. Këtë e pranon edhe vetë pala e paditur AKKP, sikundër është evidentuar në paragrafin nr. 39, të këtij vendimi. Përsa i përket pretendimeve që kanë të bëjnë me pozicionimin e saktë të kësaj prone, rezulton se këto pretendime kjo palë i ka ngritur edhe gjatë gjykimit të çështjes në shkallët më të ulëta dhe rezulton se gjykatat kanë marrë ekspert për përcaktimin e vendodhjes së pronës. Përsa i përket pretendimeve të ngritura në rekurs mbi parcelën prej 12700 m², pjesë e kësaj sipërfaqeje, se kufitarët e pronës nuk kanë vendim njohje të së drejtës së pronësisë, Kolegji vlerëson se nuk mund të merren në konsideratë, pasi pala nuk ka detyrimin që të presë që kufitarët të pajisen me vendim njohje të së drejtës së pronësisë për të përcaktuar kufijtë e pronës së saj. Kolegji thekson se për këtë sipërfaqe pala e paditur nuk mohon të drejtën e pronësisë për shkak të mungesës së dokumentave, por vetëm për shkak të përcaktimit të vendodhjes, përcaktimi i së cilës është bërë me ekspert në gjykimet e faktit.

42. Përsa i përket pretendimeve të ngritura në rekurs mbi parcelën prej 37300 m², (pjesë e sipërfaqes prej 50 dynymë), përveç sa është pretenduar më sipër lidhur me sipërfaqen 12700 m², për të cilat i është dhënë përgjigje në paragrafët e mësipërm, ngrihet dhe pretendimi për mbivendosje me pronën e Hajdar Shkozës. Lidhur me këtë pretendim, në aktin e ekspertimit eksperti shprehet: *“Referuar këtij konstatimi kam bërë verifikimin në terren i kufirit të Hajdar Shkozës, të regjistruar në ZVRPP me nr. pasurie 18/44 dhe me kufirin ndarës me parcelën S2+S3, me emërtimin popullor “Vrri”, që pretendohen nga paditësi. Nga verifikimi i bërë ka konstatuar se pronat në terren nuk kanë mbivendosje me njëra – tjetrën dhe paditësi nuk ka pretendime për vendosjen e këtij kufiri dhe ky kufi përputhet me kufirin jugor të parcelës nr. 18/44. Pasaktësia dhe mbivendosja është hartografike. Për arsye të sipërcituara përcaktimi i kufirit verior të parcelës me emërtimin popullor “Vrri”, S2+S3 në planvendosjen që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit është bërë duke iu referuar kufirit të përcaktuar në terren dhe që përputhet me kufirin jugor të pasurisë 18/44, në pronësi të subjektit të shpronësuar Hajdar Shkoza.”.* Në referim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se, nuk jemi në kushtet kur vendimmarrja duhet të prishet për mosformim të drejtë të ndërgjyqësisë, pasi thirrja e personit të tretë nuk bën pjesë në ndërgjyqësinë e detyrueshme të parashikuar në nenet 367 dhe 162 të Kodit të Procedurës Civile. Por, është shumë e rëndësishme që gjendja faktike e pronës së paditësit të përputhet me gjendjen juridike të kësaj prone. Gjithashtu, gjendja faktike dhe juridike e pronës që i kthehet paditësit duhet të përputhet me gjendjen juridike të pronave kufitare. Për këtë Kolegji vlerëson se duhet të bëhet një hetim më i thelluar nga ana e gjykatës.

43. Përsa i përket sipërfaqes prej 47,4 dynymë të pretenduar nga pala paditëse dhe e njohur nga gjykatat e shkallëve më të ulëta në vendimet e tyre, rezulton se lidhur me këtë sipërfaqe e drejta e pronësisë bazohet tek pronësia mbi 341 rrënjë ullinj. Për të përcaktuar se sipërfaqja e tokës në të cilën ndodhen 341 rrënjët e ullirit është 47,4 dynymë, gjykata është bazuar në vendimin gjyqësor nr. 8790, datë 29.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

me objekt: “Vërtetimin e faktit juridik që ish pronari Abdyl Shkoza ka pasur në pronësi të tij para vitit 1946 një sipërfaqe toke 97,4 dynymë, duke përcaktuar kufijtë dhe vendndodhjen përkatëse.”. Ky vendim në arsyetimin e tij i referohet shkresës nr. 1502 prot., datë 28.10.2009, e Komunës Dajt, sipas së cilës, duke qenë se zona ku ndodhen ullinjët, pronë e Abdyl Shkozës është zonë e thyer, një rrënjë ulliri zë 140 m². Gjithashtu, sipas arsyetimit të gjykatës që i referohet kësaj shkrese, nga praktika që kjo komunë disponon, ka rezultuar që pronari i pemëve të ullirit është dhe pronari i tokës që zënë ato.

44. Nga ana tjetër pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit nuk është dakord me këtë përcaktim. Për të llogaritur sasinë e sipërfaqes që zënë rrënjët e ullinjve kjo palë i referohet nenit 4, të Ligjit nr. 7836, datë 22.6.1994, “Për çmimet e tokës bujqësore për efekt kompensimi”, sipas të cilit, një rrënjë ulliri zë një sipërfaqe toke nga 60 m². Për rrjedhojë sipërfaqja që zënë 341 rrënjë ullinj është 20,4 dynymë dhe jo 47,4 dynymë.

45. Nga sa më sipër, lidhur me sipërfaqen që zënë 341 rrënjë ullinj, duke qenë se sipas dokumenteve arkivorë, rezulton pronësia e të ndjerit Abdyl Shkoza mbi 341 rrënjë ullinj, por nuk është përcaktuar sasia e sipërfaqes së tokës që zënë këto rrënjë ulliri, Kolegji vlerëson se gjykatat duhet të kryejnë hetim të mëtejshme e më të thelluar, lidhur me përcaktimin e sipërfaqes së tokës që zënë 341 rrënjë ullinj. Në rigjykim gjykata të hetojë, nëse ekzistojnë këto rrënjë ulliri? Nëse po, të përcaktohet sipërfaqja e tokës që ato zënë dhe vendodhja e saktë e tyre. Nëse jo, të përcaktohet sa është kjo sipërfaqe, duke mbajtur në konsideratë relievin e zonës, si dhe parashikimet e nenit 4, të Ligjit nr. 7836, datë 2.6.1994, “Për çmimin e tokës bujqësore për efekt kompensimi”, si dhe të përcaktohet vendodhja përkatëse e kësaj sipërfaqeje toke.

46. Përsa i përket pretendimit në rekurs të Avokaturës së shtetit, sipas të cilit *Pala paditëse duhet të provojë në rrugë administrative ose gjyqësore faktin se është zhveshur në mënyrë të padrejtë dhe të plotë nga pronësia ndërmjet shpronësimit, konfiskimit, shtetëzimit apo marrjes me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga regjimi i kohës. Gjykata nuk kanë analizuar apo hetuar në rrugë gjyqësore mbi mënyrën se si është humbur e drejta e pronësisë. Barra e provës bie mbi palën paditëse. Hetimi gjyqësor në këtë drejtim është i detyrueshëm dhe parashikohet shprehimisht në nenin 2, të Ligjit nr. 9235/2004*, Kolegji vlerëson se fakti i shpronësimit të pronave private dhe shtetëzimi i tyre në periudhën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, është një fakt i njohur botërisht dhe nuk ka nevojë të provohet nga subjektet e shpronësuar.

47. Përsa më sipër, Kolegji vlerëson se çështja të kthehet në rigjykim dhe në përputhje me parashikimet e shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 485 (*pas ndryshimeve të sjella me Ligjin nr. 44/2021*), vlerëson që në rastin objekt shqyrtimi të vendosë prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues. Në rigjykim gjykata të hetojë, lidhur me përcaktimin e kufirit të parcelës me emërtimin popullor “Vrri”, në mënyrë që gjendja e saj faktike të përputhet me gjendjen juridike, si dhe me gjendjen juridike dhe faktike të pronave kufitare. Gjithashtu, duhet të hetohet edhe lidhur me sipërfaqen që zënë këto 341 rrënjë ullinj. Kështu, duhet hetuar nëse ekzistojnë këto rrënjë ulliri? Nëse po, të përcaktohet sipërfaqja e tokës që ato zënë dhe vendodhja e saktë e tyre. Nëse jo, të përcaktohet sa është kjo sipërfaqe, duke mbajtur në konsideratë relievin e zonës, si dhe parashikimet e nenit 4, të Ligjit nr. 7836, datë 2.6.1994, “Për çmimin e tokës bujqësore për efekt kompensimi”, si dhe të përcaktohet vendodhja përkatëse e kësaj sipërfaqeje toke.

48. Në vijim të këtij përfundimi, referuar të gjitha shkaqeve të ngritur në rekurs, në përputhje me parashikimet e shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 485, (*pas ndryshimeve të sjella me Ligjin nr. 44/2021*), sipas të cilës: “*Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil ose Kolegjet e*

Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin: ... c) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.”, Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit duhet të priset dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues. Në rishqyrtim gjykata e apelit t’i përmbahet këtij arsytimi të Kolegjit civil të Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 485, pika 1, shkronja “c”, të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I:

Prishjen e vendimit nr. 2182, datë 24.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Tiranë, më 11.11.2022